



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KONKURRENCËS  
KOMISIONI I KONKURRENCËS**

---

**VENDIM**

nr.333 , datë 21.10.2014

**“Për**

**hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit publik me objekt  
“Ndërtim i rrugës së Unazës së Jashtme Tiranë, pjesa verilindore (segmenti Kthesa  
e Saukut – Bregu i Lumit) loti 1, loti 2 dhe loti 3”**

Komisioni i Konkurrencës, me përbërjen e:

- Lindita MILO (LATI) Kryetar
- Rezana KONOMI Zv/Kryetar
- Servete GRUDA Anëtar
- Koço BROKA Anëtar
- Iva ZAJMI Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 21.10.2014,,me pjësemarrjen e Znj. Lindita Milo, Znj. Rezana Konomi, Znj. Servete Gruda dhe Z. Koço Broka, trajtoi çështjen me:

**Objekt:** Shqyrtimin e vlerësimit juridik të informacionit mbi rastin e dyshuar për marrëveshje në oferta në tregun e prokurimit publik me objekt “Ndërtim i rrugës së Unazës së Jashtme Tiranë, pjesa verilindore”.

**Baza ligjore:** Nenet 24, shkronja d), neni 26 dhe neni 42, pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

**Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:**

Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm dhe vlerësimit ligjor të Grupit të Punës mbi rastin e dyshuar për marrëveshje në oferta në tregun e prokurimit publik me objekt “Ndërtim i rrugës së Unazës së Jashtme Tiranë, pjesa verilindore”.

**VËREN SE:**

Autoriteti i Konkurrencës, në bazë të një informacioni të administruar në rrugë administrative mbi mundësinë e një marrëveshje në oferta në procedurat e prokurimit me objekt “Ndërtim i rrugës së Unazës së Jashtme Tiranë, pjesa verilindore (segmenti Kthesa e Saukut – Bregu i Lumit)”, në bashkëpunim me Agjencinë e Prokurimit Publik ka administruar informacionin e kërkuar nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatorët ofertues në procedurën e prokurimit publik të realizuar në vitin 2013, nga Autoriteti Rrugor Shqiptar, me objekt “Ndërtim i rrugës së Unazës së Jashtme Tiranë, pjesa verilindore (segmenti Kthesa e Saukut – Bregu i Lumit) loti 1, loti 2 dhe loti 3, vërehet se:

- Vlera e ofertave fituese në të tre lotet e procedurës së prokurimit është mbi 99% të fondit limit.
- Operatorë ofertues janë vetëm tre ndërmarrje.
- Fituese të loteve janë sejcila prej ndërmarrjeve pjesëmarrëse, duke krijuar një skemë rotacioni për shoqërinë që do shpallej fituese.

Nga vlerësimi ligjor i rastit sipas nenit 4 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” rezulton se ofertat në rotacion mes tre konkurrentëve dhe afërsia e vlerës së ofertës fituese në raport me fondin limit janë shenja të kufizimit të konkurrencës nëpërmjet bashkëpunimit në oferta në prokurimet publike.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 24, shkronja d, si dhe nenit 42, pika 1, të Ligjit Nr .9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, me propozim të Sekretariatit,

#### **V E N D O S I:**

- I. Hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit publik me objekt “Ndërtim i rrugës së Unazës së Jashtme Tiranë, pjesa verilindore (segmenti Kthesa e Saukut – Bregu i Lumit) loti 1, loti 2 dhe loti 3”, për të parë nëse ka ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës;
- II. Periudha e hetimit do të jetë Janar-Dhjetor 2013.
- III. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për ndjekjen e procedurave hetimore të parashikuara në Ligj dhe në aktet nënligjore përkatëse, si dhe përgatitjen e raportit të hetimit paraprak jo më vonë se dy muaj nga dalja e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

#### **KOMISIONI I KONKURRENCËS**

**Servete GRUDA**

( \_\_\_\_\_ )  
**Anëtar**

**Koço BROKA**

( \_\_\_\_\_ )  
**Anëtar**

**Iva ZAJMI**

( \_\_\_\_\_ )  
**Anëtar**

**Rezana KONOMI**

( \_\_\_\_\_ )  
**Zv/Kryetar**

**Lindita MILO (LATI)**

\_\_\_\_\_  
**K R Y E T A R**